




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MIRËQENIES  
SOCIALE DHE RINISË

## Programi Kombëtar i Praktikave të Punës

2017-07-03 15:43:00



**Qëllimi i Programit Kombëtar të Praktikave të Punës është përfitimi i një përvoje kualifikuese që ndikon në zhvillimin e aftësive profesionale, akademike, personale dhe njohja me administratën publike. Programi është një mundësi për të rinjtë profesionistë nga moshë 21 deri 26 vjeç, nga Shqipëria dhe Diaspora, të cilët kanë mbaruar minimalisht ciklin e parë të studimeve bachelor.**

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, shpall thirrjen e tretë për Programin Kombëtar të Praktikave të Punës në Administratën Shtetërore dhe Institucionet e tjera Publike.

Në këtë program ftohen të aplikojnë të rinjtë profesionistë nga moshë **21 deri 26 vjeç, nga Shqipëria dhe Diaspora**, të cilët kanë mbaruar minimalisht ciklin e parë të studimeve bachelor.

Nëse jeni duke studiuar apo keni përfunduar studimet e ciklit të parë në një nga profilet studimore të lart përmendura, jeni të mirëpritur të aplikoni. Kandidatët duhet të tregojnë interes në punën e sektorit publik dhe të kenë aftësi shumë të mira analitike dhe komunikimi

**Kujdes:** duhet të keni përfunduar minimalisht studimet e ciklit të parë 'Bachelor'.

Ky program do të zgjasë **3 muaj** dhe është **pa pagesë**.

Fituesit do të lajmërohen nëpërmjet adresës elektronike nga institucionet përkatëse.

[APLIKO TANI](#)